

VENDIM
Nr., datë2019

**PËR PROCEDURAT E ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË STREHËVE TË
PËRKOHSHME, KOMPETENCAT E SUBJEKTEVE PËRGJEGJËSE DHE
BASHKËPUNIMI NDËRMJET TYRE**

Në mbështetje të nenit pikës 2 dhe 4, të nenit 57, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:
 - a. kompetencat e subjekteve përgjegjëse për strehët e përkohshme;
 - b. mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet subjekteve përgjegjëse për strehët e përkohshme;
 - c. procedurat e administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme.
2. Administrimi i strehave të përkohshme mund të kryhet nga një prej subjekteve si më poshtë:
 - a. nga një strukturë e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - b. një ndërmarrje dhe/ose agjenci në varësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - c. subjekte private përmes një kontrate në kuadrin e partneritetit publik-privat të lidhur me ta për këtë qëllim.
3. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për mbikqyrjen e administrimit dhe të mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme.
4. Administrimi i strehave përfshin aktivitetet si më poshtë:
 - a. menaxhimi financiar, ku përfshihen planifikimi i buxhetit dhe monitorimi i zbatimit të tij;
 - b. punime mirëmbajtje, ku përfshihen:
 - i. mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta dhe hapësirave të jashtme;
 - ii. mirëmbajtja e objekteve dhe eliminimi i problemeve që lindin nga të meta të ndërtimit dhe ato që lindin nga shfrytëzimi;
 - iii. pastrim dhe dezinfektim;
 - c. kujdesi social dhe shëndetësor, ku përfshihen:
 - i. adresimi dhe menaxhimi i problemeve dhe konflikteve sociale;
 - ii. kujdesi shëndetësor për persona me HIV/AIDS, personat e pastrehë, të moshuar, etj;
 - iii. trajnim dhe aftësim profesional të punonjësve që ofrojnë shërbim shëndetësor e social në strehat e përkohshme.
5. Mirëmbajtja e strehave të përkohshme duhet të sigurojë kushte dhe mjedis të përshtatshëm për banim në respektim të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Në strehat e përkohshme nuk duhet të mungojë furnizimi me energji elektrike, uji i

pijshtëm, largimi i ujrave të zeza, masat mbrojtëse kundër zjarrit dhe shpërthimeve, si dhe çdo kusht tjetër i parashikuar nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose subjekti i ngarkuar me administrimin e strehëve të përkohshme siguron cilësinë e administrimit, duke përcaktuar kushtet minimale që duhet të plotësojë:
 - a. Mirëmbajtja e strehëve të përkohëshme, në përputhje me planin përkatës të miratuar për këtë qëllim, ku përfshihen, ndër të tjera:
 - i. kryerja e rinovimeve dhe periodiciteti i tyre,
 - ii. afati kohor për ndreqjen e defekteve,
 - iii. vazhdimësia dhe intensiteti i pastrimit dhe dezinfektimit;
 - b. Kujdesi social dhe shëndetësor, në përputhje me planin përkatës të miratuar për këtë qëllim, ku përfshihen, ndër të tjera:
 - i. lloji i shërbimeve shëndetësore që duhet të kryhen,
 - ii. numri dhe lloji i trajnimeve dhe kurseve të aftësisimit profesional që duhet të zhvillohen,
 - iii. lloji dhe frekuenca e aktiviteteve të tjera, etj.
7. Në rastet e administrimit dhe/ose mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme nga subjekte të tjerë parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore lidh kontratë me to. Kontrata parashikon:
 - a. objektin e bashkëpunimit,
 - b. tërësinë e shërbimit/ve që ofrohen,
 - c. afatin e kryerjes së shërbimit,
 - ç. të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga ky vendim dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me të
 - d. kushte ndëshkuese për subjektin që nuk respekton rregullat e administrimit të përmbushjes së shërbimit të kontraktuar
 - dh. zgjidhjen e kontratës para afatit në rast të shkeljes së rregullave të administrimit dhe/ose mirëmbajtjes, si dhe të mospërmbushjes së detyrimeve thelbësore të parashikuara nga palët, duke përfshirë edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zgjidhja e parakohshme e saj.
8. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore inspekton çdo muaj, si dhe në mënyrë të befasishme, strehët e përkohshme dhe mënyrën e përmbushjes së kontratës së lidhur nga njësia e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve nga subjekte të tjera në to, nëse ka të tillë. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore harton një raport për zbatimin e kushteve të administrimit dhe problematikave që ka ndeshur si dhe merr masat përkatëse në rast mosrespektimi të rregullave përkatëse.
9. Subjekti që administron strehët e përkohëshme raporton çdo muaj pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për zbatimin e kushteve të administrimit dhe problematikave që ka ndeshur. Në fund të vitit, subjekti administruar, harton një raport përmbledhës për aktivitetin e mirëmbajtjes dhe kujdesit social e shëndetësor të strehës së përkohshme.
10. Për administrimin e strehëve të përkohshme, njësia e vetëqeverisjes vendore ose subjekti që administron strehët e përkohshme, mbështetet nga:

- a. ministria përgjegjëse për çështjet sociale, për ofrimin e shërbimeve sociale, sipas nevojave të grupeve sociale të akomoduar në strehët e përkohshme të identifikuar nga punonjësi social, pranë strukturave të posaçme të shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - b. ministria përgjegjëse për shëndetësinë, për ofrimin e shërbimeve bazë shëndetësore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - c. ministria përgjegjëse për arsimin, për ofrimin e shërbimeve arsimore të nevojshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - ç. ministria përgjegjëse për strehimin, përmes mbështetjes financiare për sigurimin dhe, kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk siguron të ardhura të mjaftueshme, edhe për mirëmbajtjen dhe administrimin e strehëve të përkohshme nëpërmjet fondeve publike.
11. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose subjekti që administron strehët e përkohshme informon menjëherë me rastin e gritjes së një strehe të përkohshme ministritë e përmendura në pikën 10 të këtij vendimi. Këto të fundit ngarkojnë strukturat përkatëse në varësi të tyre për identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
 12. Njësia e vetëqeverisjes vendore siguron personelin e nevojshëm për të ndjekur vijimësinë e shërbimeve për familjet/përfituesit e saj duke miratuar një plan përkujdesje për përfituesit nga ky program strehimi, ndjekur zbatimin e tij aktivisht, si dhe rishikuar planin e përkujdesjes sipas nevojave. Njësia e vetëqeverisjes vendore kujdeset që të mundësojë përfshirjen e këtyre familjeve, sipas mundësive, në programe të tjera strehimi afatgjata, brenda periudhës dy-vjeçare.
 13. Për secilën familje njësia e vetëqeverisjes vendore mban një dosje personale, të cilën e përditëson sipas rastit. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të dosjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.
 14. Njësia e vetëqeverisjes vendore, menjëherë pas instalimit, ngritjes, apo ndërtimit të një strehe të përkohshme merr masa për garantimin e sigurisë së personave të vendosur në këto streha. Grupi i punës i ngarkuar me ndjekjen e mbarëvajtjes, mirëmbajtjes dhe administrimit të këtyre strehave inspekton periodikisht strehat dhe harton raporte monitorimi të herëpashershme, të cilat ia përcjell për dijeni kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rast nevojë, njofton policinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Policinë e Shtetit duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për garantimin e sigurisë së jetës së personave të strehuar në këto streha.
 15. Strehët e përkohshme janë funksionale gjatë gjithë ditës (24orë/24) dhe gjatë gjithë javës (7/7 ditë). Individët që jetojnë në një strehë të përkohshme kanë të drejtë të paraqesin ankesat pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rast se kushtet e parashikuara në këtë vendim nuk garantojnë. Kryetari ngre menjëherë grupe pune për verifikimin e ankesave dhe merr masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve në përputhje me këtë vendim.
 16. Strehët e përkohshme ngrihen, ndërtohen dhe instalohen në respektim të normave, kritereve dhe standardeve në fuqi.

17. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, arsimin, shëndetësinë, çështjet sociale, policia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Policia e Shtetit, institucionet e ofrimit të shërbimeve publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi RAMA

RELACION

PËR PROJEKT UDHËZIMIN

PËR KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË STREHËT E PËRKOHSHME

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektudhëzimi "Për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme" propozohet në zbatim të nenit 55, pika 3 të ligjit 22/2018, "Për strehimin social", me qëllim për qëllim të përcaktojë kushtet shtesë që duhet të përdoren gjatë projektimit, ndërtimit, rinovimit, blerjes ose marrjes me qira të hapësirave për programin e strehëve të përkohshme sipas ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektudhëzimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektudhëzimi nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me VKM Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", por ai parashikohet si detyrim ligjor i parashikuar nga neni 76 pika 2 e ligjit nr. 22/2018 'Për strehët sociale'.

Gjithashtu, projektakti plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Udhëzimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave. Kjo Strategji nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një kuadri ligjor të ri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektudhëzimi " Për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 55, pika 3. Projektudhëzimi sqaron kushte shtesë që duhet të përdoren gjatë projektimit, ndërtimit, rinovimit, blerjes ose marrjes me qira të të hapësirave për programin e strehëve të përkohshme sipas ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" duke miratuar kështu kuadrin e nevojshëm rregullator për zbatimin në praktikë të programit të strehëve të përkohshme. Në vazhden e projektakteve të tjera zbatuese të këtij ligji, projektudhëzimi plotëson kuadrin ligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe ofrimin e rregullave të nevojshme për dhënien e mbështetjes së nevojshme për grupe të caktuara në nevojë të shoqërisë. Konkretisht, ky projektakt plotëson kuadrin e nevojshëm për përfituesit nga programi i strehëve të përkohshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektudhëzimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës:* Akti i propozuar propozohet nga një organ kushtetues (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) dhe miratohet po nga ai organ (Ministri i Financave dhe Ekonomisë), i cili ka tagrin të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 22/2018, jemi në kushtet e plotësimin të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Udhëzim i Ministrit), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.
- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit:* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 55, pika 3 e ligjit nr. 22/2018 parashikon se: "[k]ushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin". Këto kushte adresohen plotësisht në titull si edhe në përmbajtjen e projektaktit.
- c) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë përgjegjës për strehimin propozon dhe miraton aktin.

d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 25/1); Konventën lidhur me statusin e refugjatit (neni 21, CRSR, 1951); Konventën “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre” 1990 (neni 43 (1)(d)); Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe veçanërisht neni 11/1 i saj; Rekomandimet e Përgjithshme 4 (1991) dhe 7 (1997) të cilët i dedikohen strehimit të përshtatshëm dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 16 (paragrafi 28 mbi të drejtat e grave për strehim adekuat) të Komitetit, që vepron në kuadrin e kësaj konvente të lidhura ngushtë me këtë të drejtë. Konventën Europiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë (1977); Kartën Sociale Europiane (1961); Kartën Sociale Europiane e Rishikuar (1996) dhe Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, (KEDNJ, 1950).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektudhëzim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektudhëzimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e kushteve shtesë që duhet të përdoren gjatë projektimit, ndërtimit, rinovimit, blerjes ose marrjes me qira të hapësirave për programin e strehëve të përkohshme.

Projektudhëzimi është i strukturuar në 13 pika. Pika 1 përcakton qëllimin, ndërsa pika 2 thekson se cilido kusht, standard ose normë për strehët e përkohshme hartohet dhe realizohet në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dinjitetit njerëzor dhe integritetit të përfituesve, mosdiskriminimit, përshtatjes me nevojat e veçanta dhe kushteve shëndetësore, sigurisë, higjienës, sigurimit të hapësirave bazë dhe mbrojtjes nga kushtet klimatike dhe atmosferike, si dhe përfitimit e aksesit në shërbime komunitare dhe në një jetë komunitare.

Pika 3 thekson se ky udhëzim është plotësues i kushteve apo normave të parashikuara nga legjislacioni dhe se cilido kusht, normë apo standard që nuk është parashikuar në këtë udhëzim, zbatohet në përputhje me normat, kushtet teknike apo standardet e ndërtimit të përgjithshme në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Pika 5 prezanton një tipologji të strehëve të përkohshme, ku përfshihen fjetoret dhe kampet e strehimit dhe ofron një përkufizim të tyre, ndërsa pika 6 i referohet disa prej formave alternative

që mund të përdoren për strehët e përkohshme si tendat, kasollet e parafabrikuara, strehët e ndërtuara me materiale lokale.

Pika 7 dhe 8 prezanton disa prej kushteve të ndërtimit të strehëve të përkohshme që lidhen me pozicionimin, ajrin, pastërtinë, rreziqet natyrore ose njerëzore, ekspozimin ndaj rrezatimit diellor e kushteve ekstreme klimatike apo zhurmave (përcaktohet se nuk mund të jenë më të mëdha se 85 dB), e që ofrojnë akses të automjeteve, furnizim me ujë dhe energji elektrike dhe akses në shërbimet thelbësore përmes transportit publik të rregullt ose të posaçëm, kushte për hapësira private dhe higjienë, hapësira shoqërore ose të përbashkëta për banorët si dhe hapësira të lojërave për fëmijë, parkim për administratën dhe për vizitorët, dhe sipas rastit, mund të ofrojnë vend parkimi për automjete apo biçikleta sipas rastit, për banorët. Gjithashtu parashikohet se në rastin e kampeve të strehimit apo fjetoreve me numër të lartë banorësh, për çdo grup prej 15-60 banorësh, ofrohen hapësira dhe shërbime shtesë si: hapësira gatimi, hapësira ngrënieje / mensa, hapësira për kujdes mjekësor apo psikologjik, hapësirë publike, hapësira për fëmijët, etj. Strehët që strehojnë të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara ngrihen në mënyrë që të jenë të aksesueshme dhe përshatshme për këto grupe shoqërore. Pika 9 përcakton se mjësitë përgjegjëse, për ngritjen e kampeve të strehimit, zgjedhin zona që mundësojnë të paktën 30 m² sipërfaqe trualli për banor dhe drenazhim të lehtë dhe sipërfaqe tokë të përshkueshme. Pjerrësia e rekomanduar është nga 1% deri në 5%. Pika 10 përcakton kriteret e projektimit si që mundëson rrjedhje minimale të ajrit dhe rezistencë termike të lartë, përdor materiale ndërtimi miqësore për mjedisin, lartësinë minimale dysheme-tavan është të paktën 200 cm, dhe e rekomandueshme 240 - 265 cm, të gjitha hapësirat e banueshme duhet të kenë dritare ose dyer që mundësojnë ndriçim dhe ajrim natyral, sipërfaqja e dritares duhet të jetë të paktën 1/10 e hapësirës neto / sipërfaqes së dhomës, sigurojnë akses në ujë, energji elektrike dhe gaz, dhe që mundëson ngrohje gjatë sezonit të ftohtë dhe ftohje gjatë periudhës së nxehtë. Pika 11 përcakton kërkesat funksionale si: hapësirat e shërbimeve higjienike, të ndenjes, ngrënies dhe kuzhina mund të ndahen midis banorëve apo që kur janë të veçuara nga strehët, ato duhet të vendosen në një distancë prej 6 deri në 50 metra larg, hapësirat sanitare dhe kuzhina duhet të furnizohen me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë; hapësirat e fjetjes të jenë të mbuluara dhe të sigurta për banorët dhe të veçanta dhe të sigurta për familje të ndryshme apo që të pajisen me mobilje, pajisje dhe sende të përshtatshme për të garantuar funksionalitetin dhe standardet e duhura të jetesës. Pika 12 përcakton se strehët e përkohshme ofrojnë hapësirat dhe funksionet minimale si: 3.5 m² për banor në hapësirën e strehës, duke përfshirë shërbimet sanitare dhe gatimin. Kur është e mundur, ofrohet një minimum prej 4.5 m² për banor; 1 m² kuzhinë dhe hapësirë ngrënie për banor; 1 WC të përbashkët për çdo 20 banorë, të ndara sipas seksit; 1 dush për çdo 40 banorë, të ndara sipas seksit; dhe 1 çezmë për çdo 80 persona.

Pika 13 përcakton institucionet apo strukturat e ngarkuara me zbatimin e këtij projektakti. Në fund parashikohet, në përputhje me kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektudhëzimi ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për strehimin, instituti publik i strehimit social, institucionet publike ose private që financojnë ndërtimin e strehëve të përkoshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektudhëzim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së, me asistencën e ekspertëve kombëtarë të kontraktuar nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së i cili diskutoi intensivisht dhe konsultoi projektaktin paraprakisht me punonjës të ministrive të përmendura dhe entit kombëtar të banesave, të cilët në takime të vazhdueshme dhe periodike. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa herë në takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në to çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme. Grupi i punës dhe ekspertët analizuan edhe aktet nënligjore përkatëse që kanë mbuluar rregullimet e këtij projektudhëzimi për të konstatuar nga pikëpamja historike zhvillimin e rregullimit ligjor.

Drafti iu nënshtrua, në përputhje me ligjin për konsultimin publik në fuqi në vend, procesit të konsultimit publik, transparent dhe gjithëpërfshirës përmes <http://www.konsultimipublik.gov.al/>. Përgjatë këtij procesi u paraqitën këto sugjerime, të cilat u (mënyra si u adresuan).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me kostot institucionale, projektudhëzimi nuk kërkon ndryshim të numrit të të punësuarve pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të qeverisjes qendrore të ngarkuara me zbatimin e këtij udhëzimi.

PROPOZUESI

MINISTRI

Anila Denaj